



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
REKTORI

NJOFTIM

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, shpall konkursin për personel akademik me kohë të të plotë si mëposhtë:

FAKULTETI I EDUKIMIT: 4 (katër) vende

➤ **Departamenti i Gjuhëve të Huaja: 1 (një) vend**

- **Personel akademik me kohë të plotë, Asistent Lektor për Gjuhë Gjermane 1 (një) vend Për specialiteti “Përkthim-Interpretim”.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare në specialitetin e kërkuar.
2. Të ketë eksperiencë pune në mësimdhënie në Arsimin e Lartë.
3. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të mbrojtur me dokumentin përkatës, preferohet gjuha angleze.
4. Të njohë metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe të jetë i aftë të garantojë efikasitetin dhe mbarëvajtjen e lëndëve që do të japë.

➤ **Departamenti i Letërsisë: 1 (një) vend**

- **Personel akademik me kohë të plotë: Lektor për Letërsi Shqipe 1(një) vend**

Lektor i specializuar në lëndët: “Hyrje në Shkencën e Letërsisë” dhe “Teori e Letërsisë”,

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të zotërojë gradën shkencore "Doktor i Shkencave" në "Letërsi", të fituar me rezultate të larta.
2. Të zotërojë notë mesatare të studimeve universitare dhe Master të Shkencave (të të dyja cikleve të studimit) mbi 8 (tetë).
3. Fusha e studimeve të jetë nga **Letërsia Shqipe**.
4. Të ketë botime shkencore në revista shkencore (me ISSN) dhe kumtesa në fushën përkatëse, si autor i parë.
5. Të ketë përvojë mësimdhënieje në nivel akademik, të paktën për tre vite akademike në lëndët “Hyrje në Shkencën e Letërsisë” dhe “Teori e Letërsisë”.
6. Të paraqesë syllabuset për dy lëndët e specialitetit të Letërsisë, për të cilat është hapur vendi vakant (“Hyrje në Shkencën e Letërsisë” dhe “Teori e Letërsisë”).
7. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze ose të njëjës nga gjuhët më të rëndësishme në komunikimin ndërkombëtar në fushën e letërsisë (përparësi kanë: gjuha frënge, gjermane dhe spanjolle).

➤ **Departamenti i Sociologjisë: 1 (një) vend**

- **Personel akademik me kohë të plotë, 1 (një) vend, profili Filozofi.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të jetë i kategorisë “Profesor”.
2. Të ketë eksperiencë në arsimin e lartë.
3. Të ketë referuar në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe të ketë artikuj të botuar në revista brenda apo jashtë vendit.
4. Të njohë metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe të jetë i aftë të garantojë efikasitetin dhe mbarëvajtjen e lëndëve që do të japë.

➤ **Qendra e Edukimit në Vazhdim: 1 (një) vend**

- **Personel akademik me kohë të plotë, Lektor - 1 (një) vend.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të zotëroj gradën shkencore “Doktor” në fushën e shkencave sociale.
2. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në arsimin e lartë.
3. Të ketë referuar në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe të ketë të paktën tre artikuj të botuar në revista shkencore brenda apo jashtë vendit.
4. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të mbrojtur, preferohet anglisht.
5. Të ketë njohuri dhe aftësi të mira në përdorimin e kompjuterit.
6. Të ketë aftësi të punës në grup si dhe të jetë i/e gatshme për bashkëpunime të reja.

FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE – JURIDIKE : 5 (pesë)

➤ **Departamenti i Drejtësisë : 2 (dy) vende**

- **Personel akademik me kohë të plotë nga kategoria “Lektor”, 2 (dy) vende që do të mbulojnë Profilin e së Drejtës Private.**

- Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të jenë:

1. Të kenë përfunduar me sukses studimet Bachelor + Master Shkencor (Drejtësi) ose studimet për Drejtësi të sistemit të mëparshëm 4 vjeçar me mesatare mbi 8.5 .
2. Të ketë mbrojtur me sukses Gradën Shkencore Doktor i Shkencave Juridike, profili “ E Drejtë Private”. Në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit, kërkohet që të jetë kryer procedura e njohjes së Gradës së fituar sipas legjislacionit aktual në fuqi.
3. Përvoja akademike dhe profesionale sipas profileve të kërkuara përbën avantazh për aplikantin/kandidatin për lektor.Kandidati duhet të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë në mësimdhënie.
4. Të kenë marrë pjesë në Konferenca e Simpoziume Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare dhe të kenë botuar në revista prestigjioze brenda dhe jashtë vendit, artikuj shkencorë.
5. Të zotërojë një nga gjuhët më të folura të BE-së.

➤ **Departamenti i Administrimit Publik : 2 (dy) vende**

- **Personel akademik me kohë të plotë nga kategoria “Lektor”**

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të jenë::



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORI

1. Personeli akademik kërkohet nga kategoria "Lektor"
2. Të ketë mbaruar studimet e larta në specialitetin në një nga fushat e Administrimit Publik, në sistemin e me kohë të plotë, me mesatare mbi 8.5.
3. Të ketë Gradën Shkencore Doktor në një nga fushat e kërkimit shkencor në Administrim Publik.
4. Të ketë përfunduar studimet pas universitare (Master Shkencor ose ekuivalenrimin e tij) me mesatare mbi 8.5, në një nga drejtimet e fushës studimore të Administrimit Publik.
5. Punë kerkimore shkencore në çështje të Sektorit Publik.
6. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, e vërtetuar.
7. Të ketë eksperiencë pune mbi dy – vjeçare në mësimdhënie, e vërtetuar. Angazhimi në mësimdhënie në një nga fushat e Administrimit Publik.

➤ **Departamenti i Shkencave Politike: 1 (një) vend**

- **Personel akademik me kohë të plotë në profilin "Marrëdhënie me Publikun" nga kategoria "Lektor", Komunikim.**

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të jenë:

- 1- Të ketë mbaruar studimet e larta dhe ato pasuniversitare në shkenca komunikimi, gazetari, në sistemin me kohë të plotë, me mesatare mbi 8.5.
- 2- Të ketë gradën "Doktor" në fushën e shkencave të komunikimit, gazetarisë.
- 3- Të jetë autor i minimalisht dy punimeve shkencore (Botime në revista shkencore ose pjesëmarrje në konferenca shkencore me bord editorial), në lëmin e Shkencave të komunikimit.
- 4- Të ketë eksperiencë pune mbi një vit në mësimdhënie në fushat respektive, e vërtetuar.
- 5- Të zotërojnë në nivel shumë të mirë gjuhën angleze.

FAKULTETI I STUDIMEVE PROFESIONALE : 3 (tre) vende

➤ **Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë: 1 vend**

- Personel akademik me kohë të plotë specialiteti:

1. Inxhinier Ndërtimi 1 vend

Kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për staf akademik me kohë të plotë, janë si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet e larta Bachelor dhe Masterit Shkencor (apo Diplomë e integruar e nivelit të dytë) në degën përkatëse;
2. Të ketë eksperiencë pune në profesionin e kërkuar, vjetërsia është përparësi;

3. Të ketë njohuri mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor;
4. Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë në mësimdhënie në universitet, në lëndët, sipas profilit përkatës të paktën 2 (dy) vite, e vërtetuar;
5. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze (e mbrojtur me dëshmi);
6. Të kenë njohuri mbi programet kompjuterike të avancuara;
7. Të ketë aftësi të mira në komunikim dhe bashkëpunim për punë në grup;
8. Plotëson kriteret e etikës profesionale dhe qytetare.

➤ **Departamenti i Shkencave të Aplikuara të Natyrës: 1 (një) vend**

- Personel akademik me kohë të plotë në specialitetin:

1. Drejtësi 1(nje) vend

Kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për staf akademik me kohë të plotë, janë si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në Fakultetin e Drejtësisë
2. Të kenë gradën “Doktor i Shkencave” në të Drejtën Ndërkombëtare;
3. Mesatarja e diplomave që zotëron të jetë jo më pak se 8(tetë);
4. Kandidati duhet të ketë dëshmi të aktivitetit në fushën e kërkimit shkencor(botime dhe konferenca kombëtare/ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit);
5. Të jetë angazhuar në fushën e kërkimit shkencor të mirëfillte;
6. Të jetë i aftë të garantojë cilësinë, efikasitetin dhe ekselencën e zhvillimit të lëndëve që do të japë dhe ti përgjigjet me fleksibilitet nevojave të universitetit;
7. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj;
8. Të plotësojë formularin e vetëdeklarimit , ku vërtetohet që nuk është i dënuar ose në proces gjyqësor në zbatim të ligjit Nr.138/2015.

➤ **Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore: 1 vend**

- Personel akademik me kohë të plotë në specialitetet:

1. Farmakologji (Farmaci) 1 vend

Kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për staf akademik me kohë të plotë, janë si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet e larta Bachelor dhe Masterit Shkencor (apo Diplomë e integruar e nivelit të dytë) në Farmaci, me mesataren e notave minimalisht 8 (tetë);
2. Kanë përparësi kandidatët të cilët kanë performancë të mirë profesionale dhe kanë eksperiencë përkatëse profesionale. Grada shkencore “Doktor i Shkencave”, ose qenurit në proces Doktorature, përbën favor;
3. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze (e mbrojtur me dëshmi);
4. Të ketë njohuri mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor;
5. Preferohen kandidatët që kanë lektuar më parë në IAL dhe kanë performancën më të mirë në vitet e kaluara të konkretizuara dhe me leksione cilësore të përgatitura nga ana e tyre.
6. Të kenë njohuri mbi programet bazë të kompjuterit;
7. Të ketë aftësi të mira në komunikim dhe bashkëpunim për punë në grup;
8. Plotëson kriteret e etikës profesionale dhe qytetare.

FAKULTETI I BIZNESIT 1 (një) vend

- **Departamentit të Marketingut 1(një) vend**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORI

➤ **Personel akademik me kohë të plotë**

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të jenë:

1. Të ketë mbaruar Studimet Universitare në fushën e Marketingut, Menaxhimit, Komunikimit, Internet marketingut dhe fusha të ngjashme.
2. Të jetë minimalisht në proces Doktorature.
3. Të ketë formim profesional dhe shkencor në fushën e Dixhital marketingut, Marketingun e mediave sociale, vërtetuar me çertifikatat përkatëse lëshuar nga kompani apo institucione prestigjioze vendase dhe te huaja.
4. Të ketë eksperiencë si trajnues/e në fushën e komunikimit dhe dixhital marketingut.
5. Të ketë njohuri të thelluara në menaxhimin e fushatave marketing, përfshirë web, SEO/SEM, media sociale e të tjera të ngjashme, vërtetuar me çertifikata përkatëse.
6. Preferohen kandidatët që kanë kryer studime ose trajnime në Institucione Perëndimore në këto fusha.
7. Kriteri i notës mesatare i ponderuar për të gjitha ciklet e studimeve minimalisht **9** (nëntë).
8. Të mos ketë marrë asnjë masë disiplinore gjatë marëdhënies së tij/saj me punën aktuale.
9. Të ketë realizuar botime, artikuj shkencorë dhe pjesëmarrje në Konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare me proceeding.
10. Të referojë në mënyrë ekselente leksionet në këtë fushë në gjuhën angleze.
11. Të ketë pasqyruar cilësi të lartë në dhënien dhe kontrollin e dijeve të konkretizuara në përmbajtjen cilësore të tezave.

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT: 3 (tre) vende

➤ **Departamenti i Shkencave Kompjuterike 1 (një) vend**

Personel akademik me kohë të plotë do të jenë nga kategoria Prof/Lektor

Profili i studimit

- i. Shkenca Kompjuterike
- ii. Shkenca Kompjuterike të Aplikuara
- iii. Informatikë
- iv. Inxhinieri Matematike dhe Informatike
- v. Inxhinieri Informatike
- vi. Sisteme Informatike
- vii. Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)

Kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për staf akademik me kohë të plotë, janë si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet e larta në profilin e kërkuar.
2. Preferohen kandidatë me gradën shkencore "Dr." ose në proces doktorature.
3. Kandidatët të kenë një mesatare mbi 8.

- **Departamenti Teknologji Informacioni 2 (dy) vende**
- **Personel akademik me kohë të plotë do të jenë nga kategoria Prof/Lektor**

Profili i studimit

- i. Teknologji Informacioni
- ii. Inxhinierë Informatikë
- iii. Inxhinierë Elektronike
- iv. Art dhe Multimedia
- v. Inxhinierë Telekomunikacioni
- vi. Sisteme Informacioni

Kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për staf akademik me kohë të plotë, janë si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet e larta në profilin e kërkuar.
2. Preferohen kandidatë me gradën shkencore “Dr” ose në proces doktorature.
3. Kandidatët të kenë një mesatare mbi 8.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e aplikimit për personel akademik i cili mund të shkarkohet në faqen e internetit të universitetit në adresën www.uamd.edu.al, ose të tërhiqet dorazi në zyrën e Burimeve Njerëzore të universitetit;
2. Tre letra rekomandimi nga pedagogë apo udhëheqës shkencor të kandidatit dhe të paktën një nga tre letrat të jetë nga punëdhënësi / drejtuesi i fundit nëse ka një të tillë;
3. Fotokopje të diplomave, të noterizuara;
4. Fotokopje të certifikatave të notave të noterizuara;
5. Fotokopje të dëshmimeve kualifikimi të ndryshme, të noterizuara;
6. Fotokopje të artikujve shkencorë të publikuar në revista ndërkombëtare profesionale / shkencore dhe / ose punime të tjera;
7. Fotokopje të pasaportës ose të një dokumenti identifikimi;
8. Fotokopje të noterizuara të librezës së punës nëse ka.
9. Dëshmi penaliteti ose vetedeklarim i gjendjes gjyqesore.

Diplomat, certifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, duhet të jenë të përkthyer dhe të shoqërohen me certifikatën e njehsimit, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

- **Afati i fundit i pritjes së aplikimeve është deri në datë 05.10.2018**
- Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës, në adresën;

Universiteti “Aleksandër Mosiu”, Durrës.

Fakulteti: _____

Departamenti: _____

Lagja 1, Rruga e Currilave, Durrës.

- *Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.*
- *Proçedura e përzgjedhjes së kandidaturave fillon menjëherë pas publikimit të këtij njoftimi dhe do të zhvillohet sipas Statutit dhe Rregullores të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.*